

Problematikat sociale që prekin zonat rurale dhe periferike në Shqipëri

Përgatitur nga Evelina Azizaj,
Eksperte për Zhvillimin Rural

Ky dokument është hartuar në mbështetje të një cikli të dëgjësave publike me anëtarëve të komisioneve parlamentare në kuadër të projektit "Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve", zbatuar nga IDM, Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS) dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e qeverisë britanike.



HYRJE

Komunitetet rurale, veçanërisht ato të largëta dhe malore, karakterizohen nga një ekonomi e ngushtë bazuar kryesisht në bujqësi, blegtori, turizëm, pylltari dhe aktivitete të ngjashme, dhe jeta sociale të kufizuar. Gjithashtu, ndër vite ekonomia dhe jeta sociale kanë pësuar gjithnjë rënie. Mundësitë e popullatës vendase për punësim janë të pakta dhe të ardhurat që gjenerohen janë të ulëta. Trendi i të rinjve që largohen nga këto zona është gjithnjë në rritje, duke bërë që popullsia që mbetet në komunitete të jetë e vogël në numër dhe e plakur.

Infrastruktura publike sociale dhe ekonomike është e dobët dhe shërbimet publike janë të pamjaftueshme ose mungojnë. Mungesa e aksesit në burime, shërbime dhe mundësi është e dukshme duke shkaktuar varfëri dhe përjashtim social të popullsisë së këtyre zonave. Ndryshimet e mëdha demografike në popullsinë rurale, veçanërisht trendi gjithnjë e në rritje i të rinjve që largohen nga këto zona, po rrezikon qëndrueshmërinë e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale, sigurinë ushqimore, jetën komunitare dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe peizazhit natyror.

Megjithatë, përkundër ndikimit të konsiderueshëm që ka tkurrja e zhvillimit të komuniteteve rurale në zhvillimin social ekonomik të vendit, ende nuk ka veprime konkrete dhe politika aktive për të adresuar situatën e këtyre komuniteteve në përgjithësi, e në veçanti të grupeve më të cenueshme. Politika të njëmendta të zhvillimit të qëndrueshëm rural, që marrin në konsideratë aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore në zhvillimin e këtyre zonave dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së këtyre komuniteteve ende nuk janë ndërmarrë, ose në rastet e pakta kur ka pasur nisma ato kanë qenë jo-efektive. Zbatimi i instrumentit evropian për zhvillimin e integruar rural, e njohur si qasja Leader, ende nuk është nxitur dhe mbështetur, për shkak të mungesës së vullnetit politik për ta mbështetur këtë instrument në Shqipëri.

PROBLEMATIKA

Zonat rurale në Shqipëri janë të rëndësishme si nga ana ekonomike ashtu edhe demografike, pavarësisht se kjo e dyta ka rënë gradualisht për shkak të migrimit masiv të popullsisë rurale. Nga një shoqëri kryesisht rurale në vitet '90, për herë të parë popullsia urbane kaloi atë rurale në vitin 2011. Në 2019 popullsia rurale ishte 964,791 banorë, duke përfaqësuar 38,89% e popullsisë së vendit në krahasim me 42,57% në vitin 2015. Këto shifra reflektojnë rënien e vazhdueshme të popullsisë rurale ndër vite, e cila ngushton më tej ekonominë dhe shërbimet lokale, dhe dobëson strukturën sociale të komuniteteve.

Ndërsa sektori bujqësor në Shqipëri është një sektor dinamik, dhe zonat rurale janë të pasura me burime të shumta natyrore, trashëgimi të pasur kulturore që në fakt janë gjithçka çfarë duhet për të siguruar një jetesë të mirë, migrimi nga zonat rurale në ato urbane mbetet një shqetësim i realitetit. Shumë zona rurale, në veçanti ato malore dhe të izoluara, janë të përfshira në një proces të pakthyeshëm që po i shndërron nga komunitete dinamike në emërtime thjesht gjeografike.

Shkaqet për këtë situatë janë të shumta dhe komplekse. Komunitetet rurale përballen me sfida specifike të cilat janë të lidhura me mënyrën e jetesës të bazuar në burime natyrore, dendësinë e ulët të popullsisë dhe infrastrukturën dhe transportin të paaksesueshëm,

që ndryshojnë dukshëm nga ato në komunitetet urbane. Zhvillimi rural është procesi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenien ekonomike të popullsisë që jeton në zona relativisht të izoluara dhe pak të populluara. Zhvillimi i qëndrueshëm rural është një proces i integruar, që përfshin zhvillimin social, ekonomik dhe mjedisor të zonave rurale.

Sipas Vlerësimit të Qeverisjes Vendore në Shqipëri (IDRA&HDPC 2020)¹ ka një **pabarazi të dukshme midis zonave rurale dhe urbane në lidhje me qasjen dhe disponibilitetin e shërbimeve publike**. Shërbimet specifike si ndriçimi i rrugëve, shërbimi zjarrfikës, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike, aktivitetet sportive dhe kulturore si dhe strehimi social janë më pak të disponueshme në zonat rurale. Banorët në zonat rurale i perceptojnë shërbimet publike të tilla si: kanalizimet, mirëmbajtja e rrugëve, pastrimi dhe ndriçimi publik, me cilësi më të ulët në krahasim me zonat urbane. Gjetjet tregojnë se aksesit i barabartë në shërbime përbën një sfidë, me pabarazitë rajonale dhe mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore për zonat rurale dhe gratë. Prioritetet kryesore për ndërhyrjet e qeverisjes vendore të identifikuara nga komunitetet rurale përfshijnë mirëmbajtjen e rrugëve, aksesin në ujë të pijshëm dhe ndihmën ekonomike.

Raporti i Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për të Drejtën e Zhvillimit **shpreh shqetësimet për cilësinë e jetës në zonat rurale në Shqipëri**. Raporti thekson se komunitetet e thella dhe rurale po mbeten pas sa i përket zhvillimit, duke çuar në varfëri, papunësi dhe marxhinalizim të personave që jetojnë në këto zona. (OHCHR, 2022).²

Disa nga faktorët kryesore për situatën e pafavorizuar sociale dhe ekonomike në zonat rurale:

➔ **ROLI I VETËQEVERISJES VENDORE NË ZHVILLIMIN RURAL DHE BUJQËSOR**

Reforma administrative dhe territoriale nga njëra anë dhe procesi i decentralizimit nga ana tjetër kanë zgjeruar përgjegjësitë e bashkive në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe social të territoreve vendore, duke përfshirë edhe ato rurale. Si rrjedhim, bashkitë janë aktorët kryesorë dhe më të rëndësishëm për zhvillimin e zonave rurale. Pavarësisht përgjegjësisë, vërehet se **bashkitë janë në vështirësi për të përmbushur nevojat e komuniteteve rurale në mënyrë efektive**.

Një prej sfidave kryesore pas reformës është deficitit demokratik, që lidhet me vështirësinë e qytetarëve për të aksesuar administratën vendore dhe të zgjedhurit vendor, për të kërkuar llogaridhënie, për të qenë të përfaqësuar dhe për të ndikuar vendimmarrjen. Kjo vështirësi për të qenë të përfshirë në proceset vendimmarrëse është një shqetësim i vërtetë dhe ka ndikim në zhvillimin e komuniteteve vendore, veçanërisht atyre të largëta dhe malore, të cilat mund të ndihen të izoluara nga jeta sociale, ekonomike dhe politike e bashkisë. Përrjashtimi social i këtyre komuniteteve

1 IDRA research & consulting dhe Human Development Promotion Center (HDPC). 2020. Vlerësimi mbarëkombëtar i situatës së qeverisjes vendore në Shqipëri 2020. https://portavendore.al/wp-content/uploads/2020/12/Vleresimi-i-Qeverisjes-Vendore-ne-Shqiperi-2020_compressed.pdf

2 OHCHR. 2022. Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për të Drejtën e Zhvillimit, Saad Alfarargi, Vizitë zyrtare në Shqipëri, 15-24 nëntor 2022. Vëzhgime dhe rekomandime paraprake. <https://www.ohchr.org/sites/default/files/documents/issues/development/sr/2022-11-23/20221124-eom-albania-sr-rtd-en.pdf>

i bën ato më të prekshme ndaj sfidave të zhvillimit, veçanërisht grupet vulnerabël si fermerët e vegjël, gratë dhe të rinjtë, etj.

Në nivelin e qeverisjes qendrore është shumë e vështirë të identifikosh një politikë aktive ndaj zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve rurale. Në një kohë kur emigracioni nga zonat rurale ka qenë një fenomen i vazhdueshëm në tre dekadat e fundit, dhe mirëqenia e banorëve të zonave rurale ka kërkuar vëmendje urgjente, qeverisja qendrore nuk ka mundur të zbatojë politikë publike që do të zbuste dhe parandalonte spiralen e rënies në zonat rurale.

→ PROGRAMI I 100 FSHATRAVE – NJË HAP I RËNDËSISHËM DHE NJË MUNDËSI E HUMBUR DREJT ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR RURAL

Në vitin 2017 Qeveria shqiptare lançoi Programin e njohur të ‘100 Fshatrave’,³ duke prezantuar një qasje të bazuar në territor për zhvillimin rural. Programi përfshinte tre komponentë tradicional të programeve të integruara të zhvillimit rural: përmirësimin e infrastrukturës publike; zhvillimin ekonomik lokal, investime në burimet njerëzore dhe kapitalin social. Programi u prezantua në kohën e duhur, duke ofruar një politikë gjithëpërfshirëse për zhvillim rural të integruar dhe ndërsektorial në Shqipëri. Prezantimi i programit krijoi impulsin e nevojshëm për të prezantuar zhvillimin drejtuar nga komuniteti përmes qasjes LEADER.

Edhe pse Programi ishte ambicioz, zbatimi i tij mbeti në hije. Programi kishte potencialin për të krijuar një mjedis të mirë për fuqizimin e aktorëve lokalë, duke ringjallur besimin e tyre në potencialin e zhvillimit të bujqësisë dhe agro-turizmit. Mungesa e transparencës dhe raporteve të vlerësimit bënë që efektet e tij të mbeten të paqarta. Ndërsa nga një anë Programi shënoi një pikë kthese në formulimin e strategjive të sektorit bujqësor, nga ana tjetër zbatimi i tij mbetet i diskutueshëm. Programi nuk arriti të fuqizonte iniciativat nga poshtë lart, duke humbur një mundësi kyçe për të forcuar komunitetet vendore, të cilat mund të kishin mbështetur dhe angazhuar aktivisht në ndërhyrjet e qeverisë. Nëse do të shoqërohej me një lëvizje të aktorëve lokalë, investimet e qeverisë në infrastrukturë do të kishin përshpejtuar zhvillimin rural të qëndrueshëm në zonat e përzgjedhura.⁴

→ HUMBJA E BURIMEVE TË JETESËS

Banorët e zonave rurale zotërojnë të gjitha burimet, të cilat janë të nevojshme për të siguruar cilësi të mirë të jetës. Këto burime përfshijnë: burime natyrore, parqe dhe zona të mbrojtura, burime ujore, trashëgimi të pasur kulturore, stil unik të jetesës të trashëguar brez pas brezi etj. Megjithatë, banorët e këtyre komuniteteve janë të shqetësuar dhe janë ngritur në protesta për të mbrojtur kapitalin territorial nga keqshfrytëzimi dhe për të kundërshtuar planet për ndërtimin e hidrocentraleve

3 <https://bujqesia.gov.al/programi-i-integruar-per-zhvillimin-rural-programi-i-100-fshatrave-2/>

4 Hroni, S. Azizaj, E. Janar 2018. Komentari “Qasja LEADER dhe Programi i 100 Fshatrave – Një Perspektivë Plotësuese dhe Sinergjike për Zhvillimin e Integruar të Zonave Rurale”

dhe HEC-eve nëpër lumenjtë dhe përrenjtë që kalojnë nëpër këto zona. Ndryshimi i rrjedhës së ujit, ndërtimi i tubacioneve dhe rrugëve që shoqërojnë investimet për ndërtimin e hidrocentraleve dhe HEC-eve po shkaktojnë degradimin dhe fragmentimin e habitateve, humbjen e biodiversitetit dhe peizazhit në këto komunitete, duke shkaktuar humbjen e burimeve të jetesës për popullsinë lokale.

→ EDUKIMI DHE SHËRBIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Fëmijët dhe të rinjtë e komuniteteve rurale përjetojnë sfida në lidhje me aksesin në edukim, duke përfshirë jo vetëm infrastrukturën e edukimit, vështirësitë e transportit publik por edhe cilësinë e mësimdhënies. Të dhëna zyrtare nga Ministria e Edukimit dhe Sportit tregojnë një trend negativ në lidhje me numrin e objekteve mësimore dhe regjistrimin e nxënësve në zonat rurale në të gjitha nivelet e edukimit (MES, 2023).⁵ Gjithashtu, në përgjigje të numrit të reduktuar të nxënësve, qeveria shqiptare po zbaton reformën e konsolidimit të shkollave. Si rrjedhim, mbi 20 mijë studentë mësojnë në më shumë se 2500 klasa kolektive (2021). Në shumë procese konsultuese me banorë të zonave rurale evidentohet se sfidat për të aksesuar arsimin cilësor përbëjnë ndër shkaqet kryesore në vendimin e familjeve për t'u larguar nga fshati. Në përpjekje për t'u dhënë fëmijëve edukim cilësor familjet rurale dërgojnë fëmijët e tyre për të frekuentuar shkollat në zonën urbane më të afërt duke mbajtur barrën e transportit. Në shumë raste, familjet largohen nga fshati dhe vendosen në qytet për t'u ofruar fëmijëve arsim më cilësor, dhe si rrjedhim edhe një të ardhme më të mirë.

Sfidat e komuniteteve rurale në aksesin për shërbimet e kujdesit shëndetësor janë të ngjashme si më sipër. Në kushtet e ndryshimeve të mëdha demografike në zonat rurale, edhe ofrimi i kujdesit shëndetësor është tkurrur shumë, duke përfshirë jo vetëm kushtet e këqija teknike të qendrave shëndetësore, shërbime të limituara të kujdesit shëndetësor, por edhe mungesë të stafit mjekësor në zona rurale. Kjo situatë përkeqësohet edhe më shumë nëse merret në konsideratë fakti se moshja e popullsisë së mbetur në zonat rurale është relativisht e lartë. Kjo rrit shumë nevojën për shërbime të kujdesit shëndetësor.

Komuniteti i blegtorëve, veçanërisht barinjtë, po përballen gjithnjë e më shumë me tkurrjen si pasojë e një sërë faktorësh social, ekonomikë dhe ligjor⁶. Interesi gjithnjë e më i ulët për të punuar si bari, vlerësimi i ulët i këtij profesioni dhe sakrificat e konsiderueshme janë disa prej faktorëve. Komuniteti i blegtorëve përballen me probleme të ndryshme si cilësi jetese e ulët, të ardhura të ulëta, probleme me aksesin në kullota, mungesa e lerave të ujit, mungesë aksesi në shërbimet bazë si edukim dhe shëndetësi, pamundësi për të përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore, mbështetje e pamjaftueshme në skemat kombëtare etj. Ky komunitet lidhet ngushtë me trashëgiminë kulturore jo-materiale të vendit tonë, të njohur nga UNESCO – shtegtimi, një praktikë eko-kulturore që duhet mbrojtur. Reduktimi i shpejtë i këtij komuniteti rrezikon zhdukjen e stilit të jetesës të trashëguar brez pas brezi, duke dëmtuar historinë, traditën dhe identitetin e zonave malore shqiptare. Ky komunitet i jep jetë zonave alpine të renditura nga

5 Ministria e Arsimit dhe Sportit. 2023. Vjetari Statistikor për Arsimin dhe Sportin, 2021-2022 dhe seritë kohore.

6 Grupi i punës 4: Ruajtja e kulturës tradicionale dhe nxitja e mirëqenies së komuniteteve baritore. Parlamenti i tretë Rural Shqiptar 11-13 tetor 2023

New York Times si një prej destinacioneve që duhen vizituar. Megjithatë, mungesa e mbështetjes për këtë komunitet dhe mundësia e jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit rrezikon të humbë shpejt.

Fermerët përgjithësisht janë jashtë skemës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor, duke mbetur pa përfitimet bazë të shërbimit shëndetësor dhe si rrjedhim edhe pa pension. Skema e sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor për personat e vetëpunësuar në bujqësi bazohet në pronësinë e tokës. Për shkak të problematikave të pronësisë së tokës në pjesën më të madhe të veriut të Shqipërisë, shumë fermerë nuk e disponojnë dokumentin e pronësisë së tokës. Gjithashtu, për shkak se në këto zona sipërfaqja e tokës bujqësore është e kufizuar, blegtoria është drejtimi kryesor. Si rrjedhim fermerët nuk kanë dokumentin e pronësisë së tokës, por operojnë me NIPT fermeri. Pavarësisht kësaj, ata e kanë të pamundur të përfshihen në skemat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor përmes vetëpagesës së kontributeve. Edhe pse nuk është përgjegjësia e fermerëve, ata penalizohen nga çdo aplikim në projekte, dhe nga përfshirja në skemat e sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor, ku pronësia e tokës është dokumenti i rëndësishëm.

REKOMANDIMET

Politikat për zhvillimin e zonave rurale duhet të përshtaten me kompleksitetin dhe diversitetin e mënyrave të jetesës në këto zona. Ato duhet të përmbajnë një qasje më të gjerë, duke e ditur se zhvillimi rural përfshin më tepër se vetëm bujqësinë. Si rrjedhim, përveç stimulimit të bujqësisë, politikat duhet të përfshijnë dhe të adresojnë nevojat e rëndësishme të banorëve për shërbime shëndetësore, arsim, infrastrukturë, dhe shërbime sociale. Mos marrja në konsideratë e këtyre çështjeve, mund të rezultojë në shëndet jo të mirë në popullatën rurale, performancë të ulët në edukim, izolim social, çka mund të përkeqësojë çështje të shëndetit mendor dhe abuzimi me alkoolin apo substanca narkotike. Ndaj, qasja ndërsektoriale në zhvillimin rural është e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e jetës në këto zona dhe siguruar qëndrueshmërinë e jetës dhe ekonomisë rurale.

Problematikat komplekse të banorëve të komuniteteve rurale kërkojnë politika aktive, të qëndrueshme dhe të integruar për zhvillimin rural dhe bujqësor, e shoqëruar me një paketë masash që synojnë diversifikimin ekonomik, zhvillimin bujqësor dhe rural, shërbime sociale, mirëmenaxhim për burimet natyrore dhe një sistem të mirë dhe të aksesueshëm informacioni, shërbime rurale dhe bujqësore dhe mbi të gjitha duke ndërtuar besim ndërmjet gjithë aktorëve të interesit, banorëve dhe qeverisjes.

Çështjet e zhvillimit të komuniteteve rurale janë çështje të demokracisë vendore. Vendimmarrja për zhvillimin bujqësor dhe rural ndodh praktikisht në të dyja nivelet e qeverisjes, qendrore dhe vendore. Qeverisja në të dyja nivelet duhet të ndërveprojë ngushtë me banorët dhe aktorët e interesit për të siguruar një zhvillim efektiv rural. Politikat qeveritare duhet të reflektojnë realitetet dhe nevojat e komuniteteve, duke kuptuar se ky proces është më shumë se thjesht një lidhje mes qeverisjes dhe banorëve, por është një sfidë e demokracisë. Sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm rural janë të natyrës sociale dhe ekonomike, por po ashtu janë edhe sfidat të demokracisë vendore. Për të adresuar këto sfida, duhet të gjejmë mekanizma që nxisin dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të palëve të interesit në formulimin dhe zbatimin e politikave që kanë ndikim në jetën e banorëve të zonave rurale.

Politikat me dimension territorial bëhen të rëndësishme për të adresuar sfidat e zhvillimit rural, nxitur zhvillimin ekonomik dhe përmirësuar cilësinë e jetesës së komuniteteve vendore. Instrumenti i politikës së përbashkët evropiane për zhvillimin e integruar rural, e njohur si qasja LEADER/CLLD, ka potencialin për t'u bërë një instrument shumë i rëndësishëm për promovimin e zhvillimit rural të qëndrueshëm në Shqipëri. Sfidat socio-ekonomike në nivel lokal e identifikojnë LEADER-in si një katalizator për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së komuniteteve rurale. Deri më tani, qasja LEADER pavarësisht se nuk është promovuar dhe mbështetur nga qeverisja e sektorit, mbetet instrumenti më i përshtatshëm për të adresuar çështjet e zhvillimit rural. Përvoja e hershme për të zbatuar LEADER në Shqipëri nuk është shoqëruar me mbështetjen e nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e nismave të ndërmarra në këtë drejtim. Gjatë dy dekadave të fundit, që kur qasja Leader është zbatuar nga disa programe të donatorëve, zbatimi i këtij instrumenti në Shqipëri është shënuar nga një seri mundësish të humbura dhe pritshmëri të paplotësuara të qytetarëve dhe aktorëve të interesit.

Ndërkohë, sfidat e vazhdueshme në zonat rurale, të pa adresuara nga politikat publike, kanë vazhduar të përkeqësohen. LEADER ka potencialin për të qenë një gur themeli i politikave publike, duke adresuar efektivisht këto sfida dhe duke kontribuar aktivisht në

zhvillimin e qëndrueshëm rural në të gjithë Shqipërinë rurale.⁷

Sfidat në lidhje me aksesin në arsimin cilësor dhe shërbime të kujdesit shëndetësor janë shkaqet kryesore në vendimmarrjen e familjeve për t'u larguar nga fshati në kërkim të një jete më të mirë. Ky fakt na bën të mendojmë se përmirësimi i arsimit në zonat rurale është një çështje prioritare që duhet adresuar për të parandaluar migrimin e mëtejshëm të popullatës nga zonat rurale. Qeveria, duhet të prioritetizojë dhe investojë në arsim, përmes përmirësimit të infrastrukturës, transportit të nxënësve dhe mbi të gjithë të cilësisë në arsim, si një strategji parandaluese për zbrazjen e zonave rurale. Jeta komunitare duhet të gjallërohet dhe angazhimi i gjithë aktorëve të interesit për të krijuar një mjedis të favorshëm për arsim, kujdes shëndetësor, punësim dhe pjesëmarrje sociale të grupeve të ndryshme komunitare në zonat rurale.


Kujdesi për komunitetin e barinjve dhe pastoralistëve është i rëndësishëm për ruajtjen e stilit të jetesës të trashëguar brez pas brezi. Duke ruajtur historinë, traditën dhe identitetin e zonave malore shqiptare, komuniteti mbron këtë trashëgimi të çmuar. Mungesa e mbështetjes ndaj këtij komuniteti rrezikon humbjen e trashëgimisë kulturore, mundësitë e jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit, si dhe të habitatit dhe biodiversitetit.⁸ Është emergjente hartimi i Planit të Veprimit (plan shpëtimi) me qëllim adresimin e sfidave më kritike të këtij komuniteti me masa konkrete dhe të drejtpërdrejta për të mbrojtur, mbështetur dhe fuqizuar nga ana ekonomike, sociale dhe shëndetësore. Synimi final i këtyre përpjekjeve është rikthimi vlerave tradicionale kulturore dhe profesionale të këtij komuniteti. Procesi i përgatitjes së Planit të Veprimit do të përfshijë aktivitete të ndryshme për të përcaktuar nevojat dhe potencialet e komunitetit të blegtorëve, duke përfshirë analizën e situatës ekonomike, sociale dhe mjedisore të blegtorëve në zonat malore.⁹

Rishikimi i skemës së sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor për të përfshirë personat e vetëpunësuar në bujqësi në zonat malore, ku sipërfaqja e tokës bujqësore është e kufizuar, dhe blegtoria është aktiviteti kryesor i punësimit. Rishikimi i skemës duhet të krijojë mundësi për personat që kanë NIPT aktiv fermeri, jo domosdoshmërit bazuar pronësi të tokës bujqësore, të mund të përfitojnë nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe kujdesit shëndetësor përmes vetëpagesave të detyrueshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

7 Dashi, E. Azizaj, E. Totoni, L. Shtator 2020 Dinamikat e zbatimit të qasjes Leader në Shqipëri dhe e ardhmja

8 Deklarata e Parlamentit të Tretë Rural Shqiptar (ANRD, Prill 2024)

9 Letër drejtuar MBZHR: Mbi domosdoshmërinë e veprimeve konkrete për zhvillimin e një pastoralizmi tradicional e kulturor, në ndihmë të komunitetit të barinjve në habitatet malore. (ANRD, Shkurt 2024)



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Institute for Democracy and Mediation
Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1, 1017
T: +355 4 240 0241 | C: +355 67 38 42 437
www.idmalbania.org